

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit N.Rr., për shkak të veprës penale pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 259 par.1 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga i dënuari, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.1563/2013 të datës 18.12.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.293/2018 të datës 31.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 10 dhjetor 2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e të dënuarit N.Rr., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.1563/2013 të datës 18.12.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.293/2018 të datës 31.05.2018.

## A r s y e t i m

**Vendimi i Gjykatës Themelore**

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.1563/2013 e datës 18.12.2017, të dënuarin N.Rr. e ka shpallur fajtor për veprën penale pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 259 të KPK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditë, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë nuk e liron banesën. Është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej 20 (njëzetë) €, kurse përfaqësuesi i të dëmtuarës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

## **Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës**

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.293/2018 e datës 31.05.2018, ka aprovuar si të bazuar ankesën e të dënuarit dhe ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë vetëm përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale, ashtu që të dënuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 259 par.1 të KPK-së, kurse pjesët tjera të aktgjykimit kanë mbetur të paprekura.

### **Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe të ndryshoj apo anuloj aktgjykimet e kundërshtuara.

### **Mendimi i Prokurorit të Shtetit**

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës në Prishtinë, me parashtrësën KMLP.II.nr.222/2018 e datës 29.11.2018, ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

### **Pretendimet e paraqitura në kërkesë**

Në kërkesë i dënuari thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë në dëm të tij dhe duke u shkelur dispozitat e procedurës penale pasi që me rastin e shqyrtimit gjyqësor nuk i është dhënë mundësia e mbrojtjes efektive përmes mbrojtësit profesional dhe për më tepër ka pranuar fajësinë duke u mashtruar.

Pretendohet se në rastin konkret për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor ka kaluar afati i parashkrimit absolut të ndjekjes penale pasi që për këtë vepër penale është paraparë dënimi deri në një vit burgim dhe nga kryerja e veprës penale ka kaluar afati i ndjekjes penale nga akuza e deri te procedura gjyqësore.

Më tutje pretendohet se të dy gjykatat nuk e kanë përmbushur standardin e mbrojtjes dhe gjykimin e drejtë.

### **Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës**

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Është e rëndësishme të theksohet fakti se në rastin konkret i dënuari ka bërë pranimin e fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar dhe pasi që gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë ka vazhduar me shqiptimin e dënimit. Në faqen e dytë të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 18.12.17, është konstatuar se i dënuari është udhëzuar përkitazi me të drejtat e tij e mes tjerash edhe për faktin se ka të drejtë të mbrohet vet ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas përzgjedhjes së tij, mirëpo i dënuari ka theksuar se i ka kuptuar të drejtat dhe se do të mbrohet vet gjatë procedurës, ashtu që me këtë rast i dënuari del se mjaftueshëm është njoftuar përkitazi me të drejtën e tij për të angazhuar mbrojtës.

Gjykata e shkallës së dytë në faqen e tretë të arsyetimit të aktgjykimit të saj drejt ka konstatuar se në rastin konkret nuk ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me vepër penale në vazhdimësi. Andaj, arsyetimin e theksuar nga gjykata e shkallës së dytë e pranon në tërësi edhe Gjykata Supreme e Kosovës, se vepra penale pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 259 par.1 të KPK-së, bën pjesë në veprat penale permanente dhe se gjendja e kundërligjshmërisë vazhdon deri sa të përfundohet kryerja e veprës penale, ashtu që afati i parashkrimit llogaritet me pushimin e gjendjes së kundërligjshme përkatësisht pas lirimit të paluajtshmërisë e që në rastin konkret bazuar në dispozitivin e aktgjykimit del se i dënuari që nga viti 1999 e tutje vazhdon të qëndroj në banesën e uzurpuar, andaj edhe në këtë mënyrë nuk ka arritur afati i parashkrimit siç pretendon i dënuari.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.316/2018, më 10 dhjetor 2018

Procesmbajtësi,

Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,

Valdete Daka